



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Punimjen / Predato Received / Delivered		03.08.2022	viti - god - year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
ANKESJA	4506/2022		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.554/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.554/2022 të datës 21.06.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit/
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.554/2022 e datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.nr.21/2022 i datës 07.06.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, sipas Akt emërimit me numër 03 112-487 të datës 28.12.2012 në pozitën “Ndihmës referente për ekzekutime”, me datën 15.10.2021, ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 3652 për tek Kryetari dhe Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj, lidhur me pensionimin e parakohshëm. Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 28.04.2022, ka nxjerre Vendimin Nr.03/956 sipas të cilit ka vendosur lidhur me kërkesën e ankueses për pensionim të parakohshëm me ç’rast e ka refuzuar të



njëjtën, pas obligimit nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave sipas Vendimit KA.nr.12/2022 të datës 26.04.2022 ,që Njësia e Burimeve Njerëzore të nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e ankueses për pensionim të parakohshëm.

E pakënaqur me vendimin e Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me refuzimin e kërkesës për pensionim të parakohshëm, me datën 11.05.2022, ka parashtruar ankesën me Nr.01/1016 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky i fundit me datën 07.06.2022 ka nxjerrë Vendimin KA.nr.21/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar lidhur me daljen në pensionim të parakohshëm.

Kundër vendimit për refuzim nga ana e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me pensionimin e parakohshëm, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja me datën 21.06.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3608/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të zbatimit të gabuar të procedurës administrative si dhe vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:3608/2022 të datës 21.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 24.06.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 06.07.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin KA.nr.21/2022 të datës 07.06.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 11.05.2022 e parashtruar nga ankuesja për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin KA.nr.12/2022 të datës 26.04.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin Nr.03/956 të datës 28.04.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në SKGJK; Ankesën e ankueses me Nr.01/808 të datës 08.04.2022 e parashtruar për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin A.nr.122/2022 të datës 30.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses me numër 3652 të datës 15.10.2021 e parashtruar tek Gjykata Themelore në Ferizaj; Kërkesën e ankueses me numër 356/2022 të datës 01.02.2022 e parashtruar në Gjykatën Themelore në Ferizaj; Raportin specialistik të datës 10.02.2022; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Ankesën e ankueses të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesja për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt emërimit të ankueses të datës 28.12.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës së ankueses të datës 26.08.2015; E-mailat zyrtar të datës 02.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankueses është *e pabazuar, sepse:*



Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pas kërkesave të ankueses të datës 12.10.2021 dhe 01.02.2022, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Administratorit të kësaj gjykate lidhur me pensionimin e parakohshëm, me datën 02.02.2022 Administratori i Gjykatës Themelore në Ferizaj si mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, e ka refuzuar kërkesën e ankueses për pensionim të parakohshëm, me arsyetimin se ekziston volum i madh i punëve në këtë gjykatë si dhe duke marrë parasysh numrin e pa mjaftueshëm të referentëve e me qëllim të mbarëvajtjes së punëve pranë kësaj gjykate, nuk ka rekomanduar aprovimin e kërkesës së ankueses për pensionim të parakohshëm. Ndërlidhur me këtë fakt Kolegji ka analizuar nenin 92 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka përcaktuar se: *"1. Nëpunësit civilë mund të kërkojnë pensionim të parakohshëm jo më shumë se dy (2) vjet para afatit të përcaktuar për pensionimin e tyre. Kërkesa për pensionim të parakohshëm duhet të miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës, pas pajtimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit përkatës civil"* dhe ka konstatuar, se meqenëse Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses nuk ka dhënë pëlqimin-rekomandimin lidhur me aprovimin e kërkesës së ankueses për pensionimin e parakohshëm mbi bazat e arsyeshme në drejtim të asaj që duke marrë parasysh volumin e punëve si dhe numrin e pamjaftueshëm të referentëve në këtë gjykatë, atëherë bazuar edhe mbi këto rrethana dhe në dispozitën e lartcekur, e njëjta pa miratimin e mbikëqyrësit të saj të drejtpërdrejtë nuk ka mundur të fitoj të drejtën për shkuarjen në pensionim të parakohshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ndërlidhur me këtë fakt, ka marrë për bazë edhe raportin specialistik të datës 10/02/2022, i lëshuar nga mjeku specialist neurokirg në raport me gjendjen shëndetësore të ankueses i cili ka konstatuar si në vijim se: *"pacientja nuk ka mundësi të qëndroj ulur dhe përkulur, pushim regjim shtrati një javë, kontroll pas një javë"*, andaj përkitazi me këtë fakt, Kolegji ka konstatuar se në këtë raport specialistik nuk përmendet fakti se ankuesja për kohë të gjatë mund ta ketë këtë gjendje dhe që edhe në të ardhmen do të ndikoj në shëndetin e saj, mirëpo i njëjti përshkruan gjendjen momentale se ankuesja duhet të qëndroj në regjim shtrati vetëm për një javë dhe pas këtij raporti nuk kemi pasur në ndonjë raport tjetër të ofruar nga palët në këtë procedurë që konstaton gjendjen shëndetësore ndryshe nga konstatimi mjekësor i datës 10/02/2022. Andaj ndërlidhur me këtë që u deklarue më lartë, Kolegji vlerëson se gjendja shëndetësore e ankueses nuk përben shkas që e njëjta të mund ta shfrytëzoj të drejtën për shkuarje në pensionim të parakohshëm, pa pasur bazë të mjaftueshme lidhur me gjendjen e saj shëndetësore në atë drejtim që edhe në të ardhmen e njëjta nuk do të mund ti kryente detyrat dhe përgjegjësitë e saj që dalin nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.21/2022 të datës 07.06.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.554/2022, datë 03/08/2022.

Ardita Percuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

